

TERMA REFERENCE PËR PROJEKTET TIK



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

**PROGRAMI I NXITJES DHE RRITJES SE KAPACITETEVE TE TE RINJVE NE
FUSHEN E TEKNOLOGJISE DHE INOVACIONIT**

Tiranë 2023

Përmbajtje

1. HYRJE	3
1.1. Përfituesi /Autoriteti Kontraktues	3
2. SITUATA AKTUALE NË INSTITUCION	3
OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA	4
3.1. Objektivi i Përgjithshëm.....	5
3.2. Qëllimi.....	5
3. SUPOZIMET DHE RISQET	5
4.1 Supozimet e Projektit.....	5
4.2 Rrisqet	5
5. QËLLIMI I PUNËS	5
5.1 Të Përgjithshme	6
Faza I - Faza Fillestare	7
Faza II- Fushata e Komunikimit dhe Brandimit	7
Faza III – Organizimi i takimeve me drejtuesit e shkollave dhe/ose mësuesit në gjimnaze si dhe organizimi i seancave trajnuese.	8
Faza IV – Organizimi i mini-konkurseve në gjimnaze	9
Faza V - Inkubimi dhe mentorimi i ideve	12
Faza VI - Konkursi Startup	12
Faza VII – Festival përmyllës	13
6. HAPËSIRA GJEOGRAFIKE QË DO TË MBULOHE T	13
7. SIGURIA E TË DHËNAVE TË VËNA NË DISPOZICION	14
8. LOGJISTIKA DHE KOHA	14
10. PLANIFIKIMI I BUXHETIT	14
11. AFATI KOHOR I IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT	16

1. HYRJE

1.1. Përfituesi /Autoriteti Kontraktues

Bashkia Tiranë

1.2. Historiku

Bashkia Tiranë, pas reformës administrativo-territoriale, është njësi vendore me numrin më të madh të popullsisë në vend, e cila përbëhet nga 11 njësi administrative, 13-ish komuna dhe 3 Lagjet e reja.

Tirana është një metropol që po përjeton një transformim modernizues dhe që është rikonceptualizuar nga aspekti urban si një qytet për të gjithë qytetarët. Tirana është e hapur dhe mirëpret të gjithë shqiptarët në rrethe dhe rajon, por edhe turistët dhe rezidentët e huaj. Në kuadrin e transformimeve të vazhdueshme dhe vizionin e një qyteti europian dhe me potenciale të jashtëzakonshme, Bashkia Tiranë është fokusuar dhe orientuar edhe drejt rritjes dhe promovimit të mundësive për të rinjtë e kryeqytetit nëpërmjet ofrimit të programeve të ndryshme.

Teknologjia luan një rol të pa zëvendësueshëm tashmë në botën në të cilën jetojmë, është pjesë integrale e shoqërisë, në punë, në arsim dhe në çdo fushë tjetër të jetës së njeriut. TIK mund të adresojë çështje të shumta, por misioni i saj i përgjithshëm mbetet fuqizimi dhe emancipimi i individëve me qëllim të përmirësimit të shoqërisë.

Vitet e fundit, ndryshimet e mëdha në sektorin e teknologjisë kanë patur ndikim të madh në qytet. “Smart City” është vetëm një nga etiketat në të cilat teknologjitë e ndryshme të aplikuara kanë bërë dallimin. Sistemet e transportit, të energjisë, TIK, ujit, menaxhimit të mbetjeve, janë disa nga sektorët e përfshirë në një revolucion të tillë. Masterplani TR 030 synon një qytet ku teknologjia, softëare dhe infrastruktura, do të çojë në rrugën ku sistemet e ripërtëritshme të energjisë, lëvizshmëria, ndarjet dhe ripërdorimi e riciklimi i mbeturinave do të bëjë dallimin për të gjithë qytetarët.

TIK gjithashtu ka mjaft ndikim në arsim, ku vet kurrikulat shqiptare të edukimit po përshtaten me ato të vendeve të zhvilluara. Ndaj ky moment teknologjik kërkon që fëmijët të familjarizohen në përdorimin e kompjuterave që në moshë të hershme në mënyrë që ata të përparojnë në ciklet e njëpasnjëshme arsimore. Si rrjedhojë, TIK, do të përfshihet në mënyrë të paevitueshme në të gjitha lëndët që mësojnë nxënësit, qofshin ato me karakter shkencor ose social.

Praktika ka treguar se në gjimnazet publike të Tiranës mund të gjenden shumë talente, të cilët shpesh here për shkak të mungesës së informacionit humbasin gjatë rrugës ose gjejnë zhvillim jashtë territorit të Shqipërisë. Për këtë arsye, Programi i Nxitjes dhe Rritjes së Kapaciteteve të të rinjve në fushën e Teknologjisë dhe Inovacionit, synon të rinjtë e apasionuar pas teknologjisë në gjimnazet publike.

2. SITUATA AKTUALE NË INSTITUCION

Kuadri ligjor i cili rregullon funksionet, detyrat kryesore të NJQV-ve është ligji 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” (i ndryshuar). Në mbështetje të ligjit të posaçëm, janë hartuar planet strategjike të zhvillimit të kryeqytetit (Strategjia e Zhvillimit të Qendrushëm të

Bashkisë Tiranë 2018 – 2022; Plani i Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë 2015 – 2030) në funksion të krijimit të një kuadri zhvillimor më koherent dhe të qëndrueshëm dhe sa më pranë standarteve të Bashkimit Evropian.

Bashkia Tiranë në bashkëpunim me UNDP Albania ka organizuar nismën “ Go Tirana Smart City 2016-2026” (ref [Bashkia Tiranë - TIRANA SMART CITY https://tirana.al/artikull/tirana-smart-city](https://tirana.al/artikull/tirana-smart-city)), si një paradë idesh dhe risish ekonomike, sociale e urbane me synim identifikimin e problemeve apo mundësive të shumta që ofron qyteti dhe diskutimin e ideve për investim dhe ndërhyrje. Kjo nismë u bazua në pesë koncepte kryesore:

Lëvizshmëria – Të lëvizim Lirisht

Shoqëria – Drejtimi i energjisë dhe talentit të qytetarëve

Jetesa – Një Qytet i Jetueshëm

Ekonomia – Të Ecim Përpara

Jeta Rurale – Thesari i Fshehur

Me qëllim nxitjen e mëtejshme të inovacionit tek brezi i ri, Bashkia Tiranë në bashkëpunim të ngushtë me Fondin Shqiptaro-Amerikan të Zhvillimit (AADF) do të shndërrojë Piramidën e Tiranës në një prej qendrave më të mëdha rinore dhe edukative në Ballkan për teknologjitë kreative. Rikonceptimi i Piramidës do ndjekë modelin e qendrës inovative “TUMO” në Jerevan të Armenisë që konsiderohet një model i ri edukativ dhe inovativ për sa i përket kryqëzimit të teknologjisë dhe dizajnit. Hapësira e re do të shërbejë për shkëmbim idesh e iniciativash, por edhe si një inkubator për bizneset e reja në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit duke ushqyer kulturën digjitale dhe inovatore të të rinjve shqiptarë dhe duke rritur ndjeshëm konkurrueshmërinë e Tiranës dhe vendit në arenën ndërkombëtare.

Bashkia Tiranë ofron një numër të konsiderueshëm shërbimesh ndaj qytetarëve dhe bizneseve. Në këtë kuadër janë ndërmarrë disa masa për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve për publikun nëpërmjet thjeshtimit të procedurave, duke e bërë shërbimin më të aksesueshëm për qytetarin. Janë krijuar sportele unike për ofrimin e shërbimeve si dhe është rritur numri i punonjësve në këto sportele. Është zgjeruar përdorimi i teknologjisë për rritjen e shpejtësisë dhe cilësisë së ofrimit të shërbimit, ruajtjen e të dhënave dhe sigurimin e transparences.

Një tjetër nismë e Bashkisë Tiranë është projekti “Tirana Free WiFi (Friendly)”, një nismë e cila bën të mundur që përveç aksesimit falas të internetit në ambjentet kryesore publike, informacioni të filtrohet me qëllim mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve nga përmbajtjet abuzuese online. Përdorimi i “Friendly Wi-Fi” në një wi-fi publik, e bën përvojën online të gjithësecilit të sigurt dhe të besueshme. Bashkia Tiranë është e para bashki në rajon që tashmë ka certifikatën e parë të “Friendly WiFi”.

OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA

3.1. Objektivi i Përgjithshëm

Objektivi i përgjithshëm i shërbimit të kërkuar nëpërmjet kësaj kontrate është identifikimi i talenteve të reja në fushën e inovacionit dhe teknologjisë, rritja e numrit të personave të interesuar për teknologji dhe informatikë, promovimi i tyre me mjete konkurruese dhe zhvillimi i kapaciteteve të të rinjve me anë të trajnimeve.

3.2. Qëllimi

Qëllimi i këtij projekti është të ndihmojë të rinjtë e Tiranës në rritjen e kapaciteteve dhe njohurive në fushën e teknologjisë dhe inovacionit. Bashkia Tiranë gjithashtu ka për qëllim të rrisë aksesin në informacion dhe të ndërgjegjësojë të rinjtë dhe komunitetin me suportin që Bashkia ofron për t'i mbështetur në zhvillimin e talentit si dhe eksplorimin e mundësive të reja.

3.3 Rezultatet që duhet të arrihen nga Kontraktori

Nëpërmjet këtij projekti synohet:

- Identifikimi i talenteve në fushën e teknologjisë dhe inovacionit.
- Hartimi një studimi ku janë identifikuar dhe propozuar zgjidhje për problemet e hasura.
- Aftësimi dhe zhvillimi i kapaciteteve të të rinjve.
- Organizimi i 11 mini-konkurseve midis nxënësve të gjimnazeve të Tiranës.
- Organizimi i nje eventit publik ne formatin e nje festivali me impakt rajonal.
- Promovimi i të rinjve të talentuar.
- Inkurajimi dhe stimulimi me nëpërmjet dhënies së çmimeve .

3. SUPOZIMET DHE RISQET

4.1 Supozimet e Projektit

Projekti përfshin një rrugëtim një-vjeçar me gjimnazistët dhe të rinjtë e Tiranës duke nisur nga fazat fillestare të ideimit e deri në krijimin e një produkti specifik të tyre.

4.2 Rrisqet

Faktorët që parashikohen se mund të rrezikojnë mbarëvajtjen e projektit, janë si më poshtë:

- Mungesa e bashkëpunimit me gjimnazet.
- Mungesa e kapaciteteve tek të rinjtë e gjimnazeve të kryeqytetit.
- Vonesa të mundshme në koordinim me mësuesit TIK/ drejtuesit e gjimnazeve.

5. QËLLIMI I PUNËS

Nëpërmjet kësaj kontrate, do të mundësohet:

- Identifikimi, përfshirja dhe promovimi i të rinjve të gjimnazeve të Tiranës, të cilët shfaqin talent apo dëshirë për t'u zhvilluar në fushën e TIK dhe sipërmarrjes.
- Analizimi i problematikave apo shqetësimeve të të rinjve apo mësuesve në fushën e inovacionit dhe teknologjisë.
- Hartimi i një dokumenti mbi problematikat e mbledhura dhe propozimi i zgjidhjeve dhe plan veprimit për të ardhmen.
- Inkurajimin e të rinjve për të rritur kapacitetin në fushën e teknologjisë, inovacionit, startup-ve, IT, etj.
- Organizimi i 11 mini-konkurseve midis nxënësve të 33 gjimnazeve të Tiranës (3 gjimnaze -1 konkurs).
- Organizimi i një konkursi startup ku do të konkurojnë fituesit e 11 mini-konkurseve si dhe të rinj të tjerë të kryeqytetit të interesuar.
- Shfaqja e arritjeve më të mëdha të pjesëmarrësve në programin 1 vjeçar të Bashkisë Tiranë në fushën e ICT dhe sipërmarrjes në një Festival përmbyllës të programit ku talentet e reja do promovohen.

5.1 Të Përgjithshme

Legjislacioni kryesor mbi bazën e të cilit është organizuar dhe ushtron veprimtarinë Bashkia Tiranë.

- Ligji Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, (i ndryshuar)
- Ligji Nr.44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës të Shqipërisë”
- Ligji Nr.69/2012, date 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar)
- Ligj nr. 48/2018 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar)
- Ligji Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”
- Udhëzimi Nr. 26, datë 15.8.2014 “Për zhvillimin profesional të punonjësve arsimorë” (i ndryshuar)
- Udhëzimi Nr. 12, datë 27.4.2015 “Për mbledhjen, përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale të punonjësve arsimorë të institucioneve arsimore parauniversitare dhe të nxënësve, si dhe për përmbytjen e dosjeve të tyre personale”
- Vendim nr. 621, datë 22.10.2021 “Për miratimin e strategjisë kombëtare për arsimin 2021–2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”.
- Ligji Nr. 25/2022 “Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve”

5.2 Përshkrimi i detyrës

Faza I - Faza Fillestare

Kjo fazë fillon në datën e nënshkrimit të kontratës. Gjatë kësaj faze, operatori ekonomik duhet të realizojë:

- Të njihet me grupin e punës në Institucion që do të jetë përgjegjës për monitorimin e implementimit të kontratës, duke vendosur linjat zyrtare të komunikimit.
- Të njihet me kuadrin ligjor në të cilin bazohet veprimtaria në Institucion dhe bazën ligjore në funksion të realizimit të projektit.
- Operatori Ekonomik duhet të përgatisë dhe dorëzojë projekt propozimin duke përfshirë:
 - ↳ Elementët e përmendur në këtë dokument dhe metodologjinë që do të përdoret për arritjen e objektivave të kërkuara.
 - ↳ Të dhëna lidhur me stafin që do të përfshihet në zbatim mbi rolin e secilit prej tyre në realizimin e detyrave.

Dokumentet duhet të jenë të vecanta dhe të përshkruara narrativisht në projekt propozim.

Vetëm pasi të miratohet sa më sipër kërkuar nga grupi përgjegjës për monitorimin e implementimit të kontratës nga AK, do të vijohet me fazat e mëtejme të zbatimit të detyrave të kontratës.

Faza II- Fushata e Komunikimit dhe Brandimit

Faza e dytë nis me pranimin e Planit të Veprimit nga Autoriteti Kontraktor. Kontraktuesi gjatë fazës së II-të do të mund të fokusohet, (por nuk kufizohet) në aktivitetet si më poshtë:

- Të propozojë minimalisht 3 versione të logos së projektit e cila duhet të jetë gjithëpërfshirëse dhe të ketë brenda saj elementë identifikues të projektit.
- Të krijojë një mood board/ kolazh identifikues i projektit.
- Të përgatisë një plan komunikimi dhe vizibiliteti për projektin ku të përfshihen materiale vizuale dhe fizike me imazhin e krijuar të projektit shoqëruar me logon e Bashkisë dhe logon e digitaltirana <https://digitaltirana.al/> (website në administrim të Bashkisë Tiranë)
- Të përgatisë formatin e bannerit dhe posterave që do të përdoren përgjatë projektit.
- Si website promovues do të përdoret <https://digitaltirana.al/>, por operatori do të vë në dispozicion një ndërfaqe të dedikuar e cila do të integrohet me web më sipër. Gjithashtu fushatat e komunikimit do të realizohen edhe nëpërmjet rrjeteve sociale të Drejtorisë së Përgjithshme të Teknologjisë, Inovacionit, Informacionit dhe të Dhënave në Bashkinë Tiranë .

Produktet/dorëzimet e kërkuara në fund të kësaj faze janë:

- Mockup me të gjithë propozimet.
- Materialet e kërkuara, specifikisht 1000 spila, 1000 stilolapsa, 1000 tote bags, 1000 blloqe, 1000 dosje te branduara, 1000 certifikata pjesëmarrjeje.
- 1 banner i madh i printuar me përmasa 4 x 5 m me strukturë.

- 4 rollup të printuara të përmasave 85x200 cm.
- 15 postera të branduara të përmasave A3.
- 1000 broshura të printuara të formatit A5.

Faza III – Organizimi i takimeve me drejtuesit e shkollave dhe/ose mësuesit në gjimnaze si dhe organizimi i seancave trajnuese.

Në këtë fazë OE ne bashkëpunim me stafin e Institucionit duhet të realizojë takimet me drejtuesit e gjimnazeve ose mësuesit përfaqësues të fushës TIK në 33 gjimnaze të kryeqytetit, të përcaktuara në këtë dokument. Operatori ekonomik duhet të mundësojë edhe transportin për grupin e punës për takimet e parashikuara në Termat e Referencës. Në takimet me drejtuesit e shkollave dhe/ose mësuesit e teknologjisë do të prezantohet projekti dhe synimi i Bashkisë Tiranë për të ndihmuar dhe promovuar të gjithë të rinjtë që synojnë të zhvillojnë njohuritë dhe talentin e tyre në fushën e teknologjisë, si dhe identifikimin e talentëve në shkollat respektive.

Njëkohësisht në takimet me mësuesit, do të prezantohet projekti edhe në klasat e teknologjisë/informatikës. Në mënyrë të vazhdueshme dhe të rregullt do të mbahet kontakt me mësuesit e teknologjisë, do të zhvillohen sesione informimi ku nxënësit dhe mësuesit do të informohen dhe orientohen për të gjitha detajet e projektit, në mënyrë që të jetë sa më i qartë prezantimi i projektit nga ana e tyre përkundrejt nxënësve.

Gjithashtu, për nxënësit e interesuar do të realizohen seanca trajnuese përpara realizimit të minikonkurseve.

Vendosja e materialeve promovuese në ambientet e shkollave duke përfshirë dhe teknologjinë si një mënyrë informimi për të gjithë nxënësit që duan të marrin pjesë në minikonkurse apo të jenë pjesë e projektit, por të cilët nuk janë identifikuar ose nuk kanë qënë pjesë e seancave informuese. Në brendësi të posterit do të vendoset një QR CODE, i cili do të lidhet automatikisht me webin e projektit. Të gjithë të rinjtë do të kenë mundësinë të marrin çdo informacion të nevojshëm në lidhje me të gjitha hapat e projektit dhe gjithashtu të kenë një mundësi kontakti të drejtpërdrejt me stafin menaxhues të projektit për aplikimet.

Një prej qëllimeve të tjera që ky projekt ka është edhe identifikimi i nevojave dhe sfidave që ndeshen gjatë implementimit të kurikulave në fushën e teknologjisë në gjimnazet e Tiranës. Për të mundësuar sa më sipër do të mund të realizohen, pyetësorë, anketa, takime fizike apo intervista me mësuesit.

Kontraktuesi gjatë fazës së III-të do të mund të fokusohet në aktivitetet si më poshtë:

- Ndërtimi i një kalendari takimesh në të gjitha gjimnazet e targetuara;
- Zhvillimet e prezantimeve promovuese në shkolla;
- Takime me mësuesit TIK për evidentimin e nxënësve të spikatur me ide, prirje, talente në fushën TIK.
- Realizimi i pyetësorëve/ anketave/ intervistave drejtuar mësuesve të gjimnazeve mbi evidentimin e sfidave e problematikave kryesore në TIK dhe inovacion në shkolla;
- Hapja e thirrjes për aplikime në web digitaltirana.al, dpttidh.tirana.al si dhe web zyrtar të Bashkisë Tiranë apo dhe dërgimi i thirrjes në formë elektronike tek mësuesit dhe shkollat përkatëse;

Operatori ekonomik do të duhet të përcaktojë rregulla specifike për organizimin e mini-konkurseve, si dhe kush do të marrë pjesë, kritere paraprake që do ti vijnë në ndihmë jurisë, afatet kohore. Këto përcaktime duhet të bëhen pjesë e projekt propozimit që do të dorëzohet gjatë Faza I-Faza fillestare.

Produktet e dorëzuara në këtë fazë janë:

- Dokument analizues mbi problematikat e identifikuar në gjimnaze në fushën e teknologjisë dhe sipërmarrjes si dhe propozime për ndërhyrje potenciale të BT në mbështetje të gjimnazeve qoftë në kuadër të përmirësimit të kurrikulave apo duke implementuar projekte në ndihmë të të rinjve.

Faza IV – Organizimi i mini-konkurseve në gjimnaze

- Organizimi i mini-konkurse midis nxënësve të gjimnazeve të Tiranës.
- Nxënësit do të përzgjidhen në bazë të koncept-idesë së tyre për Tiranën dhe kritereve të përcaktuara.
- Pasi janë formuar ekipet brenda shkollave, do të kontaktohet shkolla dhe nxënësit që janë përzgjedhur për të marrë pjesë në mini-konkurs për t'u informuar për ditën dhe grupin e konkurimit.
- Përzgjedhja e ekipeve më të mira për çdo gjimnaz në bazë të koncept ideo-së së tyre dhe disa kritereve të përcaktuara.
- Çdo gjimnaz do të njoftohet paraprakisht për ditën të cilën ata do të konkurrojnë dhe adresën ku do të zhvillohet event.
- Ndarja e gjimnazeve në grupe duhet bërë duke marrë parasysh vendndodhjet e shkollave.
- Konkursi mendohet të zhvillohet në palestrën/vendndodhjen më të përshtatshme gjeografikisht dhe më kushtet më të mira për t'u organizuar këto mini-konkurse.

Gjimnazet që janë menduar të përfshihen në projekt (por nuk kufizohen në)

Nr	Shkolla	Adresa
1	Mustafa K. Atatürk	Zall-Herr
2	Shkolla MB Kasallë	Kasallë
3	Bahri Nela	Zall-Bastar
4	Teknike-Ekonomike	Rr. Xhorxhi Martini 100m siper toptanit
5	Sinan Tafaj	Rr. Maliq Muço, Mbrapa Ufos ne qender
6	Asim Vokshi	Rr. Prokop Myzeqari, Mbrapa fakultetit te shkencave te natyres

7	Sami Frashëri	Rr. Barrikadave
8	Aleks Buda	Rr. Gjergj Legisi, Laprakë
9	Eqerem Çabej	Rr. Dibres, Ngjitur me fakultetin e stomatologjise ne QSUT
10	Ismail Qemali	Blv. Zhan D'Ark, Perball DP te policise
11	Avdulla Keta	Rr. Bashkim Kodra, Shkoz
12	Sandër Prosi	Rr. Irfan Tëshana, Sauk
13	Vërri	Vërri
14	Farkë	Rr. Selman Bulku, Farkë e madhe
15	Ymer Lala	Surrel
16	Karl-Gega	Rr. Bernardin Palaj
17	Gjergj Canco	Rr. Bernardin Palaj
18	Hoteleri Turizëm	Rr. Frang Bardhi. Ne cepin ku bashkohet rr. E kavajes me rr. Frang Bardhi
19	Myslym Keta	Rr. Llambi Bonata, Kombinat
20	Myslym Shima	Kashar ngjitur me posten Shqiptare
21	Sadik Stvileci	Rr. Sadik Petrela, Kashar
22	Kashar Qendër	Rr. Azem Galica, Kashar
23	Sadi Nuri	Ndroq ne rrugen kryesore
24	16 Shtatori	Peze ne rruge kryesore
25	Shkolla Vaqar	Vaqar ne rruge kryesore
26	Feti Vogli Baldushk	Baldushk ne rruge kryesore
27	Ibrahim Hasmema	Mullet
28	Krrabë	Krrabë
29	Kllojkë	Kllojkë ne rruge kryesore
30	Mersin Duqi	Ibë ne rruge kryesore
31	Petro N. Luarasi	Rr. Sami Frashëri
32	Besnik Sykja	Blv. Bajram Curri, Përballë UET
33	Arben Broci	Rr. Besim Imami

Për cdo rast, shkollat pjesëmarrëse do të defininohen gjatë FAZËS I.

Kushtet e palestrës/ vendndodhjeve ku do të zhvillohen konkurset do të evidentohen në takimet informuese që do të zhvillohen nëpër gjimnazet e Tiranës. Gjimnazistët e përzgjedhur nga secili gjimnaz do të formojnë ekipe brenda shkollës së tyre dhe do të konkurojnë me ekipet e gjimnazeve të tjera në mini konkurset që do të zhvillohen sipas grafikut e metodologjise së të propozuar nga OE gjatë FAZËS I.

3 ekspertë të fushave TIK dhe sipërmarrje do të përzgjidhen për të qenë pjesë e jurisë për mini-konkurset dhe konkursin startup në bazë të ekspertizës së tyre. Ekspertët do të mundësohen nga Operatori Ekonomik. Juria do të vlerësojë idetë më të mira të mini-konkurseve. Vlerësimi i jurisë do të mbështetet në disa shtylla kryesore (por nuk kufizohet në)si:

- Inovacioni;
- Problemi që zgjidh;
- Vlera e krijuar;
- Realizueshmëria;
- Prezantimi;
- Ekipi si formim.

Ekipet e vendeve të para të mini konkurseve gjithashtu do të kenë të drejtën të marrin pjesë në Konkursin Start-up. Idetë më të mira të renditura në vendet e para nga ekipet e gjimnazistëve si dhe fituesit që do të dalin nga konkursi start-up do të jenë të ftuar në festivalin e madh përmbyllës së programit. Çmimet që do të shpërndahen në mini-konkurset për vendet e para do të jenë tabletët që do të sigurohen nëpërmjet kësaj kontrate. Të gjithë pjesëmarrësit do të pajisen me certifikata pjesëmarrjeje.

Secili nga mini-konkurset do të ketë maksimalisht 3 grupe fituese. OE duhet të sigurojë gjithë procesin si dhe realizimin e videove të shkurtra dhe fotografimin e të gjithë konkurseve të organizuara.

Secili nga mini-konkurset (11 të tilla) do të ofrojë për pjesëmarrësit shërbim katering në formë banketi si dhe shërbim fonie si dhe do të shoqërohet me të gjithë materialet përkatëse të komunikimit. Në lidhje me kateringun, OE duhet të sigurojë që shëndetësia, siguria dhe standartet e higjienës, të kërkuara nga legjislacioni kombëtar, të respektohen rreptësisht. OE gjithashtu duhet të sigurojë që kateringun të shoqërohet me shërbimin e personelit.

Produktet për t'u dorëzuar nga OE:

- Kalendar i konkurseve në gjimnaze.
- Listëprezencat respektive për çdo mini-konkurs.
- Aplikimet e gjimnazistëve dhe filtrimi i tyre.
- Videot e shkurtra të regjistruara përgjatë konkurseve.
- Galeria e fotove për çdo konkurs.
- Lajmi i prodhuar për web dhe rrjete sociale.

Faza V - Inkubimi dhe mentorimi i ideve

Pas mbarimit të mini-konkurseve, stafi menaxhues i projektit të OE do të identifikojë dhe evidentojë sfidat dhe mangësitë kryesore që fituesit/idetë më të mira/vendet e para kanë pasur në bazë të idesë së tyre. Fituesit e mini-konkurseve do të kalojnë përmes një procesi inkubimi/këshillimi/trajnimi i cili do të zhvillohet në bashkëpunim me mentorë dhe profesionistë të fushës së sipërmarrjes dhe TIK.

Në fund të këshillimit/trajnimi ekipet do të kenë përfituar jo vetëm aftësimin personal në teknologji dhe sipërmarrje, por edhe do të kenë përgatitur idenë e tyre për konkursin Start-up. Idetë më të mira nga ekipet e gjimnazistëve që do të dalin nga konkursi Start-up do të jenë të ftuar në Festivalin final. OE do të identifikojë dhe krijojë një kalendar këshillimi apo mentorimi për grupet fituese.

Produktet për t'u dorëzuar nga OE:

- Lista e ekspertëve
- Kalendari i mentorimit.
- Raport i detajuar mentorimi.
- Foto nga mentorimet 1 to1 ku secili mentor takon personin/grupin e përzgjedhur dhe e këshillon për idenë.
- Lajmi i prodhuar për web dhe rrjete sociale.

Faza VI - Konkursi Startup

Grupet e përzgjedhura nga fazat e mëparshme si dhe të mentoruara/këshilluara/trajnuara do të konkurrojnë në një konkurs të hapur për Startup.

Konkursi për start-up do të jetë një event në të cilin do të marrin pjesë të rinj të kryeqytetit dhe do të konkurojnë me ide në fusha të ndryshme si teknologjia, inovacioni, sipërmarrja etj. Programi është një mundësi shumë e mirë për të gjithë ata që duan të njohin më shumë botën e Startup dhe si funksionon ajo. Aktiviteti synon promovimin e inovacionit dhe sipërmarrjes tek të rinjtë pa marrë parasysh nëse janë pjesë e një biznesi dhe nëse fusha e tyre e ekspertizës është në teknologji dhe sipërmarrje, duke krijuar kështu një komunitet lokal të mendjeve sipërmarrëse dhe influencuesve të start-up për të mbështetur njëri-tjetrin dhe për t'u rritur së bashku, duke marrë reagime nga mentorët, për të prezantuar më pas përpara sipërmarrësve më të mirë dhe për të punuar së bashku në bizneset e së nesërme.

Mënyra, afatet, kriteret e aplikimit, metodologjia, do të përcaktohen nga OE në projekt propozimin e Fazës I.

Gjithashtu përgjatë kësaj faze OE do të realizojë seanca këshillimi/orientimi//trajnimi për të rinjtë pjesëmarrës mbi krijimin e modelit apo zhvillimit të idesë së tyre, mënyrës si do shfaqen para jurise etj.

Kandidatët do të prezantohen përpara jurisë e cila do të përbëhet nga juria e përzgjedhur nga OE për mini-konkurset si dhe përfaqësues nga BT si dhe komunikimi i çmimit për fituesin/fituesit. Për fituesin/fituesit do të jepet laptop që do të sigurohet nëpërmjet kësaj kontrate.

Në fund të kësaj faze do të dorëzohet dokumentacioni i detajuar sipas kërkesave të mësipërme i konfirmuar nga palët.

Në këtë fazë OE do të marrë përsipër:

- Organizimin e konkursit.
- Menaxhimin e aplikimeve për konkursin.
- Përditësimin e fushatës së komunikimit dhe brandimit me të dhënat e konkursit.
- Sigurimin e shërbimit të kateringut në formë banketi dhe personelit përkatës për konkursin.
- Sigurimin e shërbimit të fonisë për konkursin.
- Sigurimin e shërbimit të fotografisë dhe xhirimit për konkursin.
- Përgatitjen e një jurie për konkursin me pjesëmarrje edhe nga Bashkia Tiranë.

Produktet për t'u dorëzuar në këtë fazë nga OE:

- Fotot dhe videot e konkursit.
- Listëprezenca e konkursit.
- Databaza e mentorëve dhe jurisë.
- Lajmi i prodhuar për web dhe rrjetet sociale.

Faza VII – Festival përmbyllës

Në këtë faze, OE do të organizojë një event përmbyllës festimin e të gjithë procesit të zhvilluar. Të ftuar të eventit do të jenë të gjithë mësuesit përfaqësues të shkollave, drejtuesit e shkollave, aktorë të ekosistemit si dhe të rinjtë që kaluan fazën e fundit përzgjedhëse. Me një panel të përbërë nga aktorë të Bashkisë Tiranë si dhe përfaqësues të mentorëve apo jurive përgjatë projektit, konferenca do të prezantojë disa nga arritjet kryesore të projektit duke shfaqur video dhe foto përmbyllëse të tij si dhe shembuj suksesi.

Në këtë faze OE do të marrë përsipër:

- Organizimin e festivalit
- Sigurimin e shërbimit të kateringut për festivalin
- Sigurimin e shërbimit të fonisë për festivalin
- Sigurimin e shërbimit të fotografisë dhe xhirimit për festivalin
- Përgatitjen e materialit prezantues foto dhe video të projektit
- Furnizimi me pajisje tabletë dhe laptop dhe shpërndarja tek fituesit.

Dorëzimet/dokumentacionet e përmendura më sipër (Faza I-Faza VII) duhet t'i dorëzohen grupit të punës të identifikuar në kontratë, përgjegjës për zbatimin e saj nga AK.

6. HAPËSIRA GJEOGRAFIKE QË DO TË MBULOHE

Bashkia Tiranë

7. SIGURIA E TË DHËNAVE TË VËNA NË DISPOZICION

Kontraktuesi merr përsipër ruajtjen dhe konfidencialitetin e të dhënave të vëna në dispozicion nga Bashkia Tiranë, me qëllim zhvillimin e projektit dhe arritjen e rezultateve dhe përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga nënshkrimi i kontratës.

8. LOGJISTIKA DHE KOHA

8.1 Vendndodhja

Bashkia Tiranë

8.2 Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave

Data për fillimin e këtij projekti është menjëherë pas nënshkrimit të kontratës dhe kohëzgjatja e implementimit të detyrave të jetë 12 (dymbëdhjetë) muaj nga kjo datë.

9. GRUPET E SYNUARA

- Gjinnazet publike sipas përcaktimeve në këtë dokument.
- Ekosistemi i sipërmarrjes, teknologjisë dhe inovacionit në kryeqytet

10. PLANIFIKIMI I BUXHETIT

Nr.	Emërtimi	Përshkrimi i shërbimit	Njësia	Sasia
1	(FAZA II dhe FAZA III e ToRS) Fushata komunikimi brandimi dhe Organizimi i takimeve e trajnimeve	1.1 Mockup sipas termave të referencës	shërbim	1
		1.2 Spila	copë	1000
		1.3 Silolapsa	copë	1000
		1.4 Tote bags	copë	1000
		1.5 Blloqe	copë	1000
		1.6 Dosje të branduara	copë	1000
		1.7 Certifikata	copë	1000
		1.8 Banner i madh i printuar me përmasa 4 x 5 m me strukture	copë	1
		1.9 Rollup të printuara të përmasave 85x200 cm	copë	4

		1.10 Postera të branduara të përmasave A3	copë	15
		1.11 Broshura të printuara të formatit A5	copë	1000
		1.12 Shërbime transporti	shërbim	1
		1.13 Ndërfaqe Web	shërbim	1
		1.14 Shërbime të tjera	shërbim	1
2	(FAZA IV dhe FAZA V e ToRS) Organizimi i mini-kurseve në gjimnaze, Inkubimi dhe mentorimi i ideve	2.1 Katering banket për (70 x11) persona , përfshirë personel shërbyes	shërbim	1
		2.2 Shërbim fotografie, fonie, projektor	shërbim	1
		2.3 Shërbime të tjera	shërbim	1
3	(FAZA VI e ToRS) Konkursi Startup	3.1 Katering banket për 130 persona, përfshirë personel shërbimi	shërbim	1
		3.2 Shërbim kafe për 130 persona, përfshirë personel shërbimi	shërbim	1
		3.3 Shërbim fotografie dhe videomontimi , Foni, LED wall.	shërbim	1
		3.4 Shërbime të tjera	shërbim	1
4	(FAZA VII e ToRS) Organizimi i festivalit përmyllës	4.1 Katering banket për 130 persona, përfshirë personel shërbyes	shërbim	1
		4.2 Shërbim fotografie dhe videomontimi, foni, LED wall	shërbim	1
		4.3 Shërbime të tjera	shërbim	1
5	Tablet		copë	35
6	Laptop		copë	5

Shënim. Sasia e pajisjeve tabletë dhe laptopë (zëri 5 dhe 6) është e maksimalizuar. Operatori ekonomik do të furnizojë dhe faturojë nëpërmjet kësaj kontrate aq pajisje sa do të kërkohen

V	Inkubimi dhe mentorimi i ideve												
VI	Konkursi Startup												
VII	Festival përmbyllës												

Grafiku i detajuar i aktiviteteve do jetë pjesë e projekt poropozimit gjatë Fazës I.

Aneksi 1

Karakteristikat minimale teknike për Laptop

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Pikët Min. për Procesorin sipas: cpubenchmark.net Min Proc. Rating According to: cpubenchmark.net:	4500 Pikë
“Chipset”:	Intel ose Ekuivalent
“RAM”:	8 GB, DDR4 min. 2133 MHz, Non-ECC
Madhësia e Hard Diskut “HDD Size”:	500 GB HDD, 7200 RPM SATA
“Graphics”:	Integrated Graphics with 1 GB Video Memory
“Media Device”:	DVD+/-RW with DL Internal ose External; Memory card reader
Ekрани “Display”:	15.6” LED HD (1366 x 768), Anti Glare
Bateria “Battery”:	Min. 45 Wh
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Portat e Komunikimit “Ports”:	Min. (3) porta USB nga të cilat min. (2) USB 3.0 (1) DisplayPort/HDMI (1) Integrated Mic. (1) Integrated HD Web Camera (1/1) Headphone/Microphone Jack ose (1) Combo Jack
Rrjeti “Networking”:	10/100/1000 Mbps LAN (RJ-45); Wireless 802.11ac (Kompatibël me 802.11 b/g/n);Bluetooth min. V4.0
“Sound”:	Integrated , (2) x built-in speakers (stereo)
Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed O.S.”:	OEM Windows 10 64-bit Professional
Tastiera “Keyboard”:	QËERTY
“Pointing Device”:	Touch Pad
Siguria “Security Management”:	Embedded Security TPM 2.0
AKSESORËT	
Kabëll “Poëer Cord”:	Po, European

Ushqyesi “Recharger”:	Po
“Mouse”:	Po, i të njëjtës Markë me Laptopin
Çanta “Carrying Bag”:	Po, nga Prodhuesi. E përshtatshme për Laptop dhe Aksesorët e tjerë.
“Recover”:	Recover Partition
GARANCIA	
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”:	3 Vjet

Karakteristikat minimale teknike për Tablet

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
“Processor Cores”:	Quad Core
“RAM”:	2 GB
Memorie e Brendëshme “Internal Memory”:	32 GB
“Removable Memory”:	Të Suportojë Kartë Memorje min. 32 GB
“Sensors”:	G-Sensor Internal GPS-Internal
Ekрани “Display”:	≥ 9.7” HD 1024x768 multitouchscreen
Bateria “Battery”:	6000 mAh ose min. 4 Orë Punë
Kamera “Camera”:	Kamera para 2 Megapixel Kamera kryesore 3 Megapixel
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Portat e Komunikimit “Ports”:	Micro USB ose USB Tipi C
Rrjeti “Networking”:	3G, 4G/LTE Wireless 802.11ac (Kompatibël me 802.11b/g/n); Bluetooth min. V4.0;
Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed O.S.”:	PO
AKSESORËT	
Ushqyesi “Recharger”:	Po, European 220 V AC, 50 Hz
Flip Cover:	Po
GARANCIA	
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”:	1 Vjet

Aneksi 2

Specifikime të shërbimeve në funksion të aktiviteve të projektit (referuar fazës II dhe III në Termat e Referencës)

- a) Organizimi i mini-konkurseve
 - Katering banket për 70 persona, përfshirë personel shërbyes
 - Foni, projektor

- Shërbim fotografie
- b) Organizimi i konkursit final
- Katering banquet për 130 persona, përfshirë personel shërbyes
 - Pushim kafe për 130 persona, përfshirë personel shërbyes
 - Ambient për zhvillimin e konkursit final, me kapacitet mbajtës minimalisht për 150 persona, me hapësirë për krijimin e panelit të jurisë dhe vendosjen e bazës materiale, përfshirë këtu një hapësirë stage dhe ekran LED.
 - Shërbim fonie
 - LED wall
 - Shërbim fotografie dhe videomontimi
- c) Organizimi i Festivalit përmbyllëse të projektit
- Katering banquet për 130 persona, përfshirë personel shërbyes
 - Shërbim fonie
 - LED wall
 - Shërbim fotografie dhe videomontimi

Aneksi 3

Specifikimi i shërbimit të ekspertizës që do të mundësohet nga OE.

Përgjatë fazave të projektit, OE do të mundësojë 12 ekspertë ndër të cilët:

- a) 9 prej tyre do të jenë mentorë të cilët do të angazhohen kryesisht (por nuk kufizohen) në:
- Mentorimin e ideve të biznesit për pjesëmarrësit e zgjedhur në fazën V. Mentorimi do të zhvillohet në formatin 1to1, pra takime individuale fizike ose virtuale me personin ose grupin e kualifikuar. OE do të raportojë punën me foto dhe një raport të shkurtër narrativ mbi idetë dhe vijimësinë për secilin mentor/ekspert.
 - Këshillimin e të rinjve gjatë konkursit final të startup në fazën VI. Mentorët do të angazhohen duke ndihmuar pjesëmarrësit në nevoja ad-hoc lidhur me prezantimet e tyre.
- b) 3 prej tyre do të jenë ekspertë anëtarë jurie të cilët do të angazhohen në:
- Përzgjedhjen e ideve finaliste në 11 mini-konkurset e organizuara .
 - Përzgjedhjen e ideve finaliste në konkursin e startup-eve

Në secilin angazhim, OE do të raportojë pikësimin sipas formës së vlerësimit që do t'u vihet në dispozicion ekspertëve me kriteret e përzgjedhjes së idesë .